

I. Parimet bazë dhe struktura e prokurorisë

Prokuroria është organ kushtetues organizimi dhe funksionimi i së cilës rregullohet me dispozitat e pjesës së dhjetë të Kushtetutës, “Prokuroria”, ku janë parashikuar funksionet e saj si organi që ushtron ndjekjen penale si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj. Kushtetuta përcakton se prokuroria është organizuar dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor.

Ligji organik nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, detajon më tej aspekte të organizimit dhe funksionimit të Prokurorisë.

Kështu:

1.1 Prokuroria ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në emër të shtetit në gjyq, merr masa dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale, drejton dhe kontrollon veprimatrinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen detyra të tjera të parashikuara me ligj.

Misioni i prokurorisë është t’i shërbejë publikut duke proceduar veprat penale me përgjegjësi, në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe objektive, të mbrojtë të drejtat e individit dhe të bashkëpunojë me të gjithë aktorët e sistemit të drejtësisë për të forcuar zbatimin e ligjit dhe shtetin e së drejtës.

Prokuroria i ushtron funksionet në mënyrë të pavarur nëpërmjet prokurorëve.

1.2 Organizimi dhe drejtimi i prokurorisë

Prokuroria përbëhet nga:

- a) Prokuroria e Përgjithshme;
- b) Prokuroria e Posaçme, sipas ligjit të posaçëm;
- c) prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm;
- ç) prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

Drejtimi dhe përfaqësimi i prokurorisë, sipas këtij organizimi, bëhet, respektivisht, nga:

- a) Prokurori i Përgjithshëm;
- b) Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme;
- c) drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm;
- ç) drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

II. Buxheti

1. Prokuroria ka buxhet të pavarur, si pjesë e Buxhetit të Shtetit dhe parashikohet në një zë të veçantë të tij.

2. Buxheti i prokurorisë, në të cilin përfshihet buxheti i Prokurorisë së Përgjithshme, buxheti i prokurorive pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe buxheti për Policinë Gjyqësore të seksioneve pranë prokurorisë hartohet nga Prokurori i Përgjithshëm dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin përkatës të menaxhimit buxhetor e financiar.
3. Në rastin kur propozimi i buxhetit të prokurorisë nga Këshilli i Ministrave është i ndryshëm nga ai i propozuar nga Prokurori i Përgjithshëm, ky i fundit ka të drejtë të marrë pjesë në procedurat parlamentare për të mbrojtur projektbuxhetin e propozuar.
4. Buxheti i Prokurorisë përfshin të ardhura nga donacione dhe çdo të ardhur tjetër të ligjshme.
5. Buxheti i Prokurorisë së Posaçme, mënyra e hartimit dhe zbatimit të tij rregullohen me ligjin përkatës.

Tavanet e miratuara nga Ministria e Financave (në mijë lekë), për vitin 2016, janë si vijon:

Totali i Buxhetit	1,859,095
Kosto personeli	1,190,000
Kosto operacionale	339,095
Investime	330,000

III. Sistemi i pagave

Paga dhe përfitimet e tjera të prokurorit deri në zbatimin e sistemit të ri të pagave dhe përfitimeve të tjera sipas ligjit për statusin, rregullohen me dispozitat e ligjit 8737/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar¹ dhe akte të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Po kështu neni 116 i ligjit 97/2016 parashikon që “Dispozitat në fuqi për pagat, shpërblimet dhe trajtimin financiar të prokurorëve dhe administratës së prokurorive shfuqizohen pasi të jetë vënë në zbatim sistemi i ri i pagave dhe përfitimeve, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Konkretisht në ligjin 8737/2001 parashikohet se:

Paga e prokurorëve

Paga e Prokurorit të Përgjithshëm është e barabartë me pagën e Kryetarit të Gjykatës së Lartë. Paga e prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme është e barabartë me pagën e anëtarit të Gjykatës së Lartë.

Paga e drejtuesve të hallkave, që janë prokurorë në strukturën e Prokurorisë së Përgjithshme, është 5 për qind me e lartë se paga e prokurorëve të kësaj prokurorie.

¹ Sistem që do të jetë në fuqi deri në janar 2019, bazuar në nenet 169 dhe 173 të ligjit 96/2016.

Paga bazë e prokurorit ose drejtuesit të prokurorisë së shkallës së parë dhe të apelit, si dhe shtesa për vjetërsi apo vështirësi në shërbim e tyre, është e barabartë me pagën dhe shtesën e vjetërsisë dhe të vështirësisë së gjyqtarit e të kryetarit të gjykatës, pranë së cilës funksionon prokuroria, ku ai është emëruar.

Funksionet dhe struktura e pagave	
Prokurori i Përgjithshëm	<p>Në ligjin nr.8737, dt.12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 52/1 përcaktohet se “1.Paga e Prokurorit të Përgjithshëm është e barabartë me pagën e Kryetarit të Gjykatës së Lartë.”.</p> <p>Në ligjin nr. 8588, date 15.03.2000 kreu II neni 22 është përcaktuar se paga e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë është e barabartë me pagën e ministrit ndërsa ajo e Kryetarit të Gjykatës së Lartë është 20 % më e lartë se paga e gjyqtarit të kësaj gjykate.</p> <p>Në ligjin nr.9584 date 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, në lidhjen nr.1 pika C/1, përcaktohet koeficienti me të cilin do të bëhen llogaritjet e pagave dhe konkretisht është 0.68 %. Ligji 147/2015 “Për buxhetin e vitit 2016” neni 12 parashikon se “Paga e Presidentit të Republikës është 257 000 lekë në muaj.”.</p>
Prokuror	<p>Në ligjin nr.8737, dt.12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 52/3 përcaktohet se: “Paga bazë e prokurorit ose drejtuesit të prokurorisë së shkallës së parë dhe të apelit, si dhe shtesa për vjetërsi apo vështirësi në shërbim e tyre, është e barabartë me pagën dhe shtesën e vjetërsisë dhe të vështirësisë së gjyqtarit e të kryetarit të gjykatës, pranë së cilës funksionon prokuroria, ku ai është emëruar.”.</p> <p>Në ligjin nr.9877 datë 18.02.2008 “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 27 është përcaktuar se paga e gjyqtarit dhe e kryetarit të gjykatës së apelit, është 75 % të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.</p> <p>Referuar ligjit 114/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9877 datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 26, është përcaktuar se paga e gjyqtarit dhe kryetarit të gjykatës së shkallës së parë është 60 % e pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë</p>

Shënim:

- *Prokurorët Drejtor në Prokurorinë e Përgjithshme kanë shtesë page për funksion nga 5% deri në 20%.*
- *Prokurorët Shef Sektori në Prokurorinë e Përgjithshme kanë shtesë page për funksion nga 3% deri në 10%.*
- *Drejtuesit e Prokurorisë së Apelit Tiranë dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit për Krime të Rënda kanë shtesë page për vështirësi 10%.*
- *Drejtuesit e Prokurorisë për Krime të Rënda dhe drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë kanë shtesë page për drejtim dhe vështirësi 40% me shumë se prokurorët e këtyre prokurorive.*
- *Disa drejtuesve të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë kanë shtesë page 20% për vështirësi në punë.*
- *Prokurorët pranë Task Forcës kanë shtesë page për vështirësi në masën 20%.*

Paga e oficerëve të seksioneve të Policisë Gjyqësore

Struktura e pagave të oficerëve të policisë gjyqësore	
Oficerë të policisë gjyqësore pranë Prokurorisë së Përgjithshme	Paga e oficerit të Policisë Gjyqësore-jurist, të seksionit të Prokurorisë për Krimet e Rënda dhe Prokurorisë së Apelit për Krimet e Rënda, si dhe të zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm është 20 për qind më e lartë se ajo e parashikuar për oficerin e policisë gjyqësore - jurist në seksionet e prokurorive të rretheve.
Oficerë të policisë gjyqësore pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda	
Oficerë të policisë gjyqësore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda	
Oficerë të policisë gjyqësore pranë Gjykatave të Shkallës së Parë	Paga e oficerit të olicisë gjyqësore-jurist, të seksioneve të prokurorive të rretheve gjyqësore dhe të prokurorive të apelit është e barabartë me 70 për qind të pagës së prokurorit të prokurorisë së rrethit gjyqësor.

Shpërblimet

Në bazë të ligjit nr.8677, datë 02.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, i ndryshuar, oficerët e policisë gjyqësore, të emëruar nga Prokurori i Përgjithshëm, mund të përfitojnë shpërblime, për merita profesionale, në masën e caktuar, me propozimin e drejtuesit dhe me miratimin e Prokurorit të Përgjithshëm. Kriteret për shpërblim për merita të veçanta për oficerët e Policisë Gjyqësore, të emëruar nga Prokurori i Përgjithshëm, janë përcaktuar me udhëzimin nr.1/2011 të Prokurorit të Përgjithshëm.

Administrata e prokurorisë

Sekretari i Përgjithshëm është nëpunësi më i lartë civil në Prokurorinë e Përgjithshme. Punonjësit e administratës të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm u nënshtrohen rregullave të ligjit 97/2016 dhe për sa nuk parashikohet dhe nuk bie në kundërshtim me të edhe dispozitave të ligjit për Statusin e Nëpunësit Civil. Nëpunësit civilë paguhen sipas vendimit të Këshillit të Ministrave **nr.545/2011, i ndryshuar.**

Prokuroria e Përgjithshme	
Funksioni	Struktura e pagës
Sekretar i Përgjithshëm	I-a
Drejtor Kabineti	I-a
Këshilltar	I-b
Drejtor Drejtorie	II-b
Përgjegjës sektori	III-a
Ekspert	III-a
Ndihmës Ligjor	III-a
Ndihmës i viktimave	III-a
Specialist	III-b

Marrëdhëniet e punës të personelit administrativo-teknik rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës. Punonjësit mbështetes paguhen sipas vendimit të Këshillit të Ministrave **nr. 717/2009, i ndryshuar.**

Prokuroria e Përgjithshme	
Funksioni	Struktura e pagës
Sekretare	VIII
Oficer informacioni	VIII
Punonjës i postës sekrete	VIII
Punonjës shërbimi	VII
Shofer i postës sekrete	VI
Shofer	V
Pastruese	III
Prokuroritë e tjera	
Kancelar	II-b VKM 545/2011 i ndryshuar Në ligjin nr.8737, dt.12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 57 përcaktohet : “Prokurori i Përgjithshëm mund të emërojë kancelarë për

	ndjekjen e problemeve të karakterit administrativ e financiar. Paga e tyre është e njëjtë me atë të kancelarëve pranë gjykatave.”.
Kryetar dege buxhet financë	
Kryesekretar	VKM 545/2011, i ndryshuar
Sekretare pranë prokurorëve	
Sekretare	
Ftues	
Specialist	VKM 717/2009, i ndryshuar
Shofer	
Pastruese	